



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 15 tetor 2019

Z. Fitim Sadiku, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Punëve të Jashtme

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 496/2019
kundër
Ministrisë së Punëve të Jashtme

I nderuari z. Sadiku,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike,¹ më 6 qershor 2019, e ka pranuar ankesën e z. Ardit Kikës, gazetar i pavarur, parashtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesi, më 24 prill dhe më 5 qershor 2019, përmes postës elektronike, i është drejtuar MPJ-së me kërkesë për qasje në dokumentin e fundit të deklasifikuar në MPJ. Po ashtu ankuesi i ka parashtruar edhe pyetjet në vijim:

1. A është formuar ndonjëherë në MPJ, komision për klasifikim të informacioneve?
2. Sa dokumente janë klasifikuar gjatë vitit 2018?
3. A ka miratuar MPJ lista të dokumenteve të klasifikuara dhe lista të shpërndarjes së tyre?
4. A mund të na konfirmoni se MPJ pranon dokumente të klasifikuara nga ambasadat e saj?
5. Cilat janë nivelet e klasifikimit të dokumenteve të MPJ-së?

Avokati i Popullit, më 20 qershor dhe më 12 korrik 2019, i është drejtuar me shkresa Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ-së, nëpërmjet të cilave ka kërkuar informata lidhur me veprimet që MPJ-ja i ka ndërmarrë përkitazi me kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentet dhe të dhënat e kërkuara. Më 31 korrik 2019, IAP-ja ka kontaktuar me zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me veprimet që MPJ-ja i ka ndërmarrë përkitazi me ankesën, por nuk ka pranuar përgjigje.

Avokati i Popullit thekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], paragrafi 1, përcakton: “Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.” Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: “Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e drejtuar nga ankuesi është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

E drejta për t'u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 19 i së cilës përcakton: “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë.” Lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - [Liria e Shprehjes]: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi nga MPJ-ja i kërkesës së ankuesit, përveçqë është në kundërshtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, i përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1: “Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”

Avokati i Popullit rikujton se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), sipas neni 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Në rastin *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, GjEDNj-ja ka vlerësuar: “Liria e shprehjes përbën një nga themelet esenciale të një shoqërie demokratike, bazuar në paragrafin 2 të nenit 10 të KEDNj, dhe është e zbatueshme jo vetëm për “informacion” apo “ide” të cilat pranohen apo vlerësohen. [...] Jo vetëm që shtypi ka për detyrë të transmetojë informacione dhe ide të tilla, por publiku gjithashtu ka të drejtë t'i pranojë ato. Sikur të ishte ndryshe, shtypi nuk do të ishte në gjendje të luante rolin e tij jetësor të “mbikëqyrësit publik”.² Po ashtu, në rastin *Lingens v. Austria*, GjEDNj-ja jua rikujton: “[...] të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjegjerësisë, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Këto parime kanë një rëndësi të veçantë për sa i përket shtypit.” [...].³

Avokati i Popullit vlerëson se përjashtimet e së drejtës për qasje në dokumente janë të përcaktuara në nenin 17 të LQDP-së. Ndërsa informacionet mund të kufizohen vetëm për qëllime të mbrojtjes së interesave legjitime publike, të jetës ose të interesave të tjera legjitime private, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq me vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe cenim të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit konstaton se, në rastin e ankuesit, MPJ-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar nga ankuesi, gjë që është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare.

Obligimi ligjor për bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit konstaton se MPJ-ja, përveçse ka dështuar t'i përmbushte obligimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41 dhe neni 132, paragrafi 3), po ashtu ka dështuar t'i përmbushte obligimet që burojnë nga LQDP-ja dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit (neni 25), në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga

² Case of *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, (App. no. 13585/88, 26 November 1991. Paragraph 59 (a) (b)).

³ Case of *Lingens V. Austria* (App. no. 9815/82), 8 July 1986, paragraph 41.)

nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative, duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyt në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

Me qëllim të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i


REKOMANDON

Ministritë së Punëve të Jashtme

- *Ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet në pajtim me Ligjin 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.*
- *T'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmermi lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit